

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTERIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2023

LËNDA: GJEOGRAFI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30	31	32
Pikët								
Kërkesa	33	34						
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Trupi qiellor më i afërt me Diellin është: 1 pikë
- A) Jupiteri.
B) Afërdita.
C) Marsi.
D) Merkuri.
2. Në cilin paralel bien pingul rrezet e Diellit në datën 21 mars? 1 pikë
- A) Në Tropikun e Jugut.
B) Në Tropikun e Veriut.
C) Në Ekuator.
D) Në Rrethin Polar Jugor.
3. Toka nuk ka formë të përkryer. Ajo është e shtypur në: 1 pikë
- A) gjerësitë mesatare.
B) tropikë.
C) pole.
D) ekuator.
4. Vija që bashkojnë vende me lartësi të njëjtë quhen: 1 pikë
- A) izobare.
B) izohieta.
C) izobate.
D) izohipse.
5. Reshjet atmosferike që formohen nga lëvizjet vertikale të ajrit quhen: 1 pikë
- A) konvektive.
B) orografike.
C) advektive.
D) frontale.
6. Përcakton sasinë e ujit që rrjedh në një sekondë nëpër një prerje tërthore të lumit: 1 pikë
- A) prurja;
B) rrjedhja;
C) koeficienti i rrjedhjes;
D) niveli.
7. Kur gropat e krijuara nga tretja e gipseve mbushen me ujë, formohen liqenet me origjinë: 1 pikë
- A) tektonike
B) karstike
C) bregdetare
D) akullnajore

8. Sipas shkallës së Mosit fortësinë më të madhe e ka: **1 pikë**
- A) talku.
 - B) ortoklazi.
 - C) diamanti.
 - D) kuarci.
9. Veprimtaria gërryese e detit quhet: **1 pikë**
- A) abrazion.
 - B) erozion.
 - C) korazion.
 - D) deflacion.
10. Shqipëria gjendet në gadishullin: **1 pikë**
- A) Apenin.
 - B) Ballkanik.
 - C) Krimesë.
 - D) Skandinav.
11. Cilët janë malet më të lartë në Evropë? **1 pikë**
- A) Malet Urale.
 - B) Malet Penine.
 - C) Malet Alpe.
 - D) Malet Skandinave.
12. Cili nga lumenjtë e Amerikës së Veriut derdhet në Gjirin e Meksikës? **1 pikë**
- A) Rio Grande.
 - B) Makenzi.
 - C) Jukon.
 - D) Kolumbia.
13. Sipas modelit të tranzicionit të popullsisë, faza e parë e tij karakterizohet nga: **1 pikë**
- A) Nivel i ulët i lindjeve.
 - B) Shtim i ulët natyror.
 - C) Jetëgjatësi e lartë.
 - D) Nivel i ulët i vdekjeve.
14. Gjysmëhëna pjellore gjendet midis lumenjve: **1 pikë**
- A) Tigër dhe Euftrat.
 - B) Nil dhe Kongo.
 - C) Ind dhe Gang.
 - D) Jance dhe Huanhe.

15. Lumi Gang shtrihet në rajonin e: 1 pikë

- A) Azisë Juglindore.
- B) Azisë Lindore.
- C) Azisë Qendrore.
- D) Azisë Jugore.

16. Emigrimi në Shqipëri ishte i ndaluar gjatë periudhës së: 1 pikë

- A) principatave.
- B) pushtimit osman.
- C) mbretit Zog.
- D) komunizmit.

17. Rajoni i Republikës së Shqipërisë që ka dalje në detin Jon është: 1 pikë

- A) Rajoni Jugor.
- B) Rajoni Juglindor.
- C) Rajoni Perëndimor.
- D) Rajoni Verior dhe Verilindor.

18. Mali i Trebeshinës është formuar në një: 1 pikë

- A) antiklinal.
- B) sinklinal.
- C) graben.
- D) horst.

19. Popullsia greke, malazeze dhe ajo e Maqedonisë së Veriut që jeton në Shqipëri konsiderohet si: 1 pikë

- A) pakicë kombëtare;
- B) pakicë kulturore;
- C) grup etno-kulturor;
- D) grup kulturor-kombëtar.

20. Ndërtohet nga shkëmbinj gëlqerorë dhe dallohet për relievin karstik: 1 pikë

- A) malësia e Gashit.
- B) malësia e Martaneshit.
- C) malësia e Çermenikës.
- D) malësia e Gollobordës.

21. Vëzhgoni me kujdes figurën e dhënë.

a) Cili lloj projeksioni hartografik është përdorur?

b) Si paraqiten meridianët dhe paralelet në këtë lloj projeksioni?




1 pikë

1 pikë

22. Fronti atmosferik formohet në zonën kufitare të takimit të dy masave ajrore me veçori fizike të ndryshme.

a) Emërtoni llojin e frontit që tregohet në figurë.



1 pikë

b) Shpjegoni se si formohet ky lloj fronti dhe përcaktoni motin që sjell:

2 pikë

Formimi: _____

Moti që sjell: _____

23. Baticat dhe zbaticat janë ngritje dhe ulje periodike të nivelit të ujit të detit.

a) Cili është faktori kryesor që ndikon në formimin e baticave dhe zbaticave?

1 pikë

b) Shpjegoni se kur ndodhin baticat më të mëdha, duke e ilustruar edhe me figurë.

2 pikë

24. Korja tokësore përbëhet nga shkëmbinj të llojeve të ndryshëm. Shkruani dy dallime midis shkëmbinjve sedimentarë dhe metamorfikë.

2 pikë

Dallimi i parë:

Dallimi i dytë:


25. Lumi gjatë rrjedhjes së tij kryen veprimtari gërryese, transportuese dhe grumbulluese.

a) Në cilën pjesë të lumit është më e madhe veprimtaria grumbulluese? 1 pikë

b) Jepni dy kushte kur veprimtaria grumbulluese e lumit është më e madhe. 2 pikë

26. Shkruani tri veçori fiziko - gjeografike të rajonit të Evropës Jugore. 3 pikë

27. Figurat tregojnë piramidën e popullsisë së një shteti në dy periudha të ndryshme kohore.



a) Në cilën nga piramidat paraqitet jetëgjatësia më e lartë? Bazohuni te të dhënat e piramidave për të arsyetuar përgjigjen tuaj. 2 pikë

b) Në cilën nga piramidat paraqitet lindshmëria më e lartë? Bazohuni te të dhënat e piramidave për të mbështetur përgjigjen tuaj. 2 pikë

28. Japonia edhe pse e varfër në pasuri minerale dhe me kushte jo shumë të favorshme fiziko-gjeografike përfaqëson një nga shtetet më të zhvilluara ekonomikisht të botës. Renditni tri nga arsytet që kanë mundësuar këtë zhvillim: **3 pikë**

29. Emërtoni dy nga veprimtaritë e sektorit të tretë të ekonomisë. **2 pikë**

30. Për t'ju përgjigjur pyetjeve, bazohuni në hartën e dhënë.

a) Hijëzoni në hartë rajonin e Amerikës Latine.



1 pikë

b) Emërtoni malet më të larta të këtij rajoni.

1 pikë

c) Emërtoni një nga qytetërimet që lulëzuan në këtë rajon.

1 pikë

31. Jepni tri nga karakteristikat fiziko-gjeografike të vargjeve malore: Trebeshinë - Dhëmbel - Nemërçkë dhe Shëndëlli - Lunxhëri - Bureto. **3 pikë**

32. Rajoni Juglindor është një nga rajonet gjeografike të Shqipërisë.

a) Emërtoni fushëgropën më të madhe të Rajonit Juglindor.

1 pikë

b) Cila nga njësitë përbërëse të Rajonit Juglindor është formuar në një horst?

1 pikë

c) Shkruani një nga pasuritë minerale për të cilat dallohet Rajoni Juglindor.

1 pikë

33. Tabela e mëposhtme tregon ecurinë e lindjeve dhe vdekjeve në Shqipëri për periudha të ndryshme kohore.

Periudha	Lindshmëria për 1000 banorë	Vdekshmëria për 1000 banorë
1945-1950	35.5	15.4
1951-1955	40.1	14.5
1956-1960	41.7	10.6
1961-1970	38.5	8.4
1971-1980	31.2	6.6
1981-1990	26.1	6.0
1991-2001	17.3	6.2
2001-2011	17	5.9

a) Në cilën periudhë është më i ulët shtimi natyror i popullsisë? 1 pikë

b) Si ndikoi ky shtim i ulët natyror në treguesit e tjerë të popullsisë? 1 pikë

c) Jepni një arsye që ka ndikuar në nivelet e shtimit të ulët natyror të popullsisë? 1 pikë

34. Në ditët e sotme fenomeni i emigrimit dhe migrimit ndikon si në aspektin demografik ashtu edhe në atë socio-ekonomik.

a) Jepni një nga efektet e migrimit të brendshëm në rajonet gjeografike të Shqipërisë, duke u bazuar te drejtimi i lëvizjes së njerëzve? 1 pikë

b) Si ka ndikuar migrimi i brendshëm në aspektet demografike të Rajonit Verior dhe Verilindor? 1 pikë

c) Shkruani një faktor që ka ndikuar në këtë ndryshim. 1 pikë
